Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Programi	**Të gjitha Programet**
Titulli i lëndës:	**Informatikë dhe Programim**
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Semestri:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Mësimdhënësi i lëndës:	**Dr. sc. Ahmet Shala**
Përshkrimi i lëndës	Njohuri bazike për përdorim të kompjuterit: sistemet operative, MS Office programi për përpunim të teksteve (Word), programi për llogaritje dhe shkrim të macrove (Excel) dhe programi për prezantime (PowerPoint). Njohuri themelore të përdorimit të softuerit MathCad në aspektin e problemeve matematikore si dhe ato komplekse: numrat kompleks, sistemet e ekuacioneve, vektorët, matricat, paraqitjet grafike të funksioneve, derivatet dhe integralet etj. Njohuri themelore të përdorimit dhe programimit në Matlab ose C++ me theks të veçantë tek vektorët dhe matricat, sistemet e ekuacioneve lineare dhe jolineare, paraqitje grafike, derivime dhe integrime sipas skemave përkatëse. Krijimi dhe kompilimi i programeve për zgjidhje të problemeve të ndryshme matematikore.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me bazat themelore të punës me kompjuter si sistemet operative, MS Office programet për përpunim të teksteve, për llogaritje, shkrim të macrove dhe për prezantim etj. Njohja e studentëve me softuerët bashkëkohor që përdoren më së tepërmi në inxhinieri në përgjithësi si Mathcad dhe Matlab. Orientim të drejt të studentit që të përvetësojë softuerët expert dhe të kohës (versionet update).
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët pas përfundimit me sukses të modulit Informatikë dhe programim, do të kanë: - Njohuri bazë dhe të rëndësishme për punë me kompjuter - Njohuri bazë dhe të rëndësishme në shfrytëzimin e softuerit MathCad - Njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe programimin në Matlab ose C++.

	- Do të kanë vlerësimet e tyre, të sigurta, aplikimet e këtyre softuerëve në kurset e ardhshme profesionale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgatitja përfundimtare për provim	20	1	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet ,etj	0	0	0
Totali			**150 orë**

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime etj.	
Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik	**Pjesa teorike (%)**	**Pjesa praktike (%)**
	40%	**60%**
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë dhe i dytë intermediar: 2x20% Vijimi i rregullt 10% Provimi final 50% **Total 100%**	
Literatura		
Literatura bazë:	[1] Ligjërata të autorizuara nga profesori. [2] Ahmet Shala, Informatika dhe Programimi, Prishtinë 2013	
Literatura shtesë:	[1] Dr. sc. Ahmet Shala, Bazat e punës me kompjuter, Prishtinë, 2011 [2] User Guide for MathCad & Matlab updated version [3] Bjarne Stroustrup, The C++ Programming Language, 4th Edition, 2013	